



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2020:160317
Datë: 19.02.2021
Numri i dokumentit: 01521967
P.nr.04/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Gëzim Ademi, me bashkëpunëtor profesional Sylejman Barja, në lëndën penale ndaj të akuzuarit: D.K., për shkak të veprës penale: Dhunë në familje nga neni 248 par.3 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2042/2020 (2020:0067426), të datës 08.01.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 22.01.2021 në prezencën e prokurorit të shtetit Natasha Taniq, të dëmtareve, A.K. dhe H.K., të akuzuarit D.K., dhe mbrojtësit të tij, Av. B.P., me datë 22.01.2021 e shpalli publikisht, ndërsa me datë 19.02.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

D.K., nga i ati A., e ëma H., e gjinisë S., “data e lindjes”..., në Mitrovicë, ku edhe tani jeton ,shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i pamartuar, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Me datë 17.11.2020, rreth orës 10:30, në Mitrovicë, në shtëpinë familjare, ka ushtruar dhunë fizike dhe psikike me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër brenda familjes dhe atë ndaj babait të tij të dëmtuarit A.K., si dhe ndaj nënës së tij H.K., në atë mënyrë që pas refuzimit të nënës H. të ia kthej thikën të cilën një natë më përpara babai i të pandehurit ia ka fshehur për arsytet sigurisë, ka filluar që të thyej gjësende nëpër shtëpi e pastaj e ka kapur për fyti , ka filluar ta ngulfatë me fjalë kanosëse se do ti vras dhe do ta djeg shtëpinë, që te të dëmtuarit ka shkaktuar frikë dhe shqetësim.

Me këtë ka kryer veprës penale: Dhunë në familje nga neni 248 par.3 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata në bazë të nenit; 1, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 43, 46, 47, 48, 49, 69, lidhur me nenin 248 par.3 të KPRK-së, dhe nenit: 365, 450, 463 të KPP-së, i:

SHQIPTON

1. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili nuk do të ekzekutohet në afat prej dy (2) vite, nëse i pandehuri gjatë kohës së verifikimit, nuk kryen vepër tjetër penale, në te kundërtën dënimi do të revokohet dhe do të ekzekutohet, dënimi me burgim në te cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar nën masën e paraburgimit nga data 17.11.2020 deri me datë 22.01.2021, DHE,
2. Dënim me gjobë në shumën prej treqind (300) euro, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së, deri në zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim me burgim, duke llogaritur 20€ (euro) për një ditë të kaluar me burg.
3. Ndaj të akuzuarit ndërpritet masa e paraburgimit, menjëherë, nga datë 22.01.2021 dhe i njëjti lirohet që të mbrohet në liri.

Në mbështetje të nenit 18 par 2 dhe nenit 87 KPRK-ës, e lidhur me nenin 503, 504, 514 të KPP-ës, të pandehurit, kjo Gjykatë i;

SHQIPTON

MASËN E TRAJTIMIT ME ANE TE REHABILITIMIT TE DETYRUSHEM I PERSONAVE TE VARUR NGA DROGA OSE ALKOOLI NË LIRI

4. Masa e trajtimit të detyruar psikiatrik në liri do të ekzekutohet në Klinikën Psikiatrike – Reparti i sëmundjeve të varësisë nga alkooli dhe droga. I pandehuri obligohet që t'i nënshtrohet trajtimit të detyruar psikiatrik dhe të paraqitet në këtë institucion sipas kohës, terminëve dhe rekomandimit të mjekëve, gjithashtu të përdorë terapinë sipas rekomandimit të ekspertëve të kësaj klinike. I pandehuri duhet të paraqitet tek ky institucion pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
5. Masa e trajtimit të detyruar do zgjasë për aq kohë sa është nevojshme për trajtimin e të pandehurit, por jo më gjatë se dy /2/ vite.
6. Klinikën Psikiatrike –Reparti i sëmundjeve të varësisë nga alkooli dhe droga, obligohet ta pranojë në trajtim të pandehurin sipas këtij aktgjykimi si dhe t'i dërgojë gjykatës, raport mbi gjendjen shëndetësore dhe suksesin e trajnimit për të pandehurin klinika obligohet t'i raportojë gjykatës së paku njëherë në dy muaj, dhe të njoftojë gjykatën për çdo vështirësi në trajtim.
7. I pandehuri paralajmërohet se në rast mosrespektimit të kësaj mase të shqiptuar, se në rast se nuk merre pjesë në trajtim, refuzon apo kanoset që të kryejë ndonjë vepër tjetër penale në këto raste Gjykata mund të vendosë për ndërrimin e masës dhe shqiptimin e masës së trajtimit të detyruar me ndalim.
8. Obligohet i akuzuari, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, për ekspertizë mjeko-ligjore shumë prej 300 euro, në emër të paushallit gjyqësorë të paguajë shumën prej 10€, në emër të taksës për kompensimin e

viktimave të krimit shumë prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

9. Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ndaj të akuzuarit D.K. ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.2042/2020 (2020:0067426), të datës 08.01.2021, për shkak të veprës penale: Dhunë në familje nga neni 248 par.3 të KPRK-së.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, të mbajtur me datë 22.01.2021 në këtë seancë, i akuzuari e ka pranuar fajësinë në tersi për veprën penale si në aktakuzën e lartcekur, duke theksuar se e ndjej vetën fajtor për veprën penale që më vihet në barrë, ndihem i penduar, i premtom gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë më vepra të ngjashme apo të ndryshme si dhe i propozon Gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të më shqiptoj një dënim sa më të butë.

Prokurori, lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se konsideroj se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion, pranimi mbështetet në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, prandaj i propozoj gjykatës që ta pranoj pranimin e fajësisë dhe këtë pranim të fajësisë ta marrë parasysht si rrethanë lehtësues me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit. Ndërsa ka theksuar, se nuk duhet të merret parasysht si rrethanë lehtësuese pendimi i të pandehurit, ashtu siç u deklarua sot gjatë deklarimit, për arsye se edhe gjykata edhe prokuroria është njoftuar se ka edhe tjera procedura penale për vepër penale Dhunë në familje, çka në rastin konkret tregon që i pandehuri është recidivist. Mbesë në tersi mbetem pranë aktakuzës duke argumentuar se nga provat dhe pranimi i fajësisë është vërejtur se i akuzuari ka kryer veprën penale, andaj i ka propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, e po ashtu, ndaj tij të shqiptoj edhe masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri.

I dëmtuari A.K.në lidhje me pranimin e fajësisë ka deklaruar se, kërkoj nga gjykata që mos ta dënoj, për arsye se jemi pajtuar si familje, e kam djalë dhe nuk dëshiroj të dënohet si dhe kemi raporte shumë të mira.

E dëmtuara H.K. në lidhje me pranimin e fajësisë ka deklaruar se, jemi pajtuar me të pandehurin si dhe nuk dëshiroj që ta dënoj djalin tim, e ka pranuar fajin, jemi pajtuar si dhe tani kemi raporte shumë të mira me të pandehurin.

Mbrojtësi Av.Besim Parduzi në lidhje me pranimin e fajësisë ka deklaruar se, pas konsultimit më klientin tim, e njëjta pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare, pranimi mbështetet në provat dhe shkresat e lëndës, andaj i propozoj gjykatës që ta pranoj pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim, si dhe i propozoj gjykatës që t'i merr parasysht të gjitha rrethanat lehtësuese me rastin e përcaktimit të dënimit. Po ashtu, propozoj gjykatës që ndaj të njëjtës ta ndërpres masën e paraburgimit.

Vlerësimi i gjykatës:

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilin e ka deklaruar i akuzuari, e në mbështetje të nenit 248 të KPP-ës, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit sa i përket veprës penale, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: Raporti fillestar i

incidentit i datës 17.11.2020; Raporti i policit, i datës 17.11.2020; Deklarata e të dëmtuarës H.K. dhënë në polici, datë 17.11.2020; Deklarata e të dëmtuarit A.K. dhënë në polici, datë 17.11.2020; Raportet mjekësore nga Ordinanca Psikiatrike "RINA" në Mitrovicë të datës 27.12.2019, 10.01.2020, 04.02.2020 në emër të akuzuarit D.K.; Raporti për gjendjen e shëndetit mendor për të akuzuarin D.K. i hartuar nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike i Kosovës (tutje: IPFK), datë 22.12.2020; Deklarata e të akuzuarit D.K. dhënë në polici, datë 17.11.2020 si dhe fotografitë nga vendi i ngjarjes. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë të tyre dhe pranimi të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i akuzuari, ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është bërë në mënyrë vullnetare, se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, duke iu tërhequr vërejtja të akuzuarit se pas pranimi të fajësisë, nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarit.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të akuzuarit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari D.K. ka kryer veprën penale: Dhunë në familje nga neni 248 par.3 të KPRK-së, për të cilën është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim deri në tre (3).

Sipas urdhërësës për ekzaminimin psikiatrik për të akuzuarin, me datë 22.12.2020, gjykata ka pranuar një raport për gjendjen e shëndetit mendor për të akuzuarin të hartuar nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës. Gjykata, bazuar në theksimet e raportit shëndetësor dhe në deklaratimet e palëve në procedurë duke përfshirë edhe deklaratimin e vet të akuzuarit vërtetoi se i akuzuari e ka kryer veprën penale, aftësia e të kuptuarit dhe kontrollës së veprimeve të veta ka qenë e zvogëluar joesencialisht, andaj i shqiptoi masën e precizuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo për arsye se përgjegjësia penale lidhet në mënyrë të ngushtë me aftësinë e personit për të kuptuar natyrën e paligjshme të sjellës së tij, si edhe për të kontrolluar veprimet ose mosveprimet në përputhje me kërkesat e ligjit. Bazuar në konstatimet e dalura nga ekspertiza me shkrim e datës 22.12.2020, e përpiluar nga Dr. J.Z., Dr. A.G. dhe Dr. A.B., kanë konstatuar se në momentin e kryerjes së veprave penale nga ana e të akuzuarit aftësia mendore e të kuptuarit dhe kontrollës së veprimeve të saj ka qenë e zvogëluar joesencialisht, pasi për shkak të përdorimit të substancave të ndryshme psikopative ka pësuar çrregullim mendor të karakterizuar nga një shqetësim i theksuar që shkaktohet nga një grup problemesh që recidivojnë, të cilat lidhen me përdorimin e substancave psikopative, kombinuar kjo me një kontroll të dëmtuar mbi përdorimin e tij, pavarësisht dëmtimit që mund të shkaktojë ky përdorim. Andaj, i ka propozuar gjykatës që ndaj të njëjtit të shqipton masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri.

Gjykata e ka pranuar këtë konstatim të ekspertëve mjekësor me bindjen se trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri për të akuzuarin është i nevojshëm dhe adekuat për shërimin e vet të akuzuarit dhe për të shmangur rrezikun për kryerjen e ndonjë vepre tjetër penale. Po ashtu gjykata vlerëson se një trajtimi në institucion do të mundësojë përcjelljen e gjendjes shëndetësore të tij në mënyrë permanente, nga ekipi profesional konform gjendjes së tij, që do t'i mundësojë atij rikthim të sigurve në rrethin familjar dhe shoqëror.

Andaj, gjykata konstaton se edhe përkundër faktit se i akuzuari e ka kryer veprën penale në gjendje jo esencialisht të zvogëluar mendore, i njëjti ka përgjegjësi penale sipas nenin 18 par.2 të KPRK-së, e cila dispozitë shprehimisht përcakton se: “Personi i cili ka kryer vepër penale konsiderohet se ka aftësi të zvogëluar mendore nëse në kohën e kryerjes së veprës penale aftësia e tij për të kuptuar natyrën dhe rëndësinë apo pasojën e veprimeve ose mosveprimeve të tij ka qenë esencialisht e zvogëluar për shkaqet e cekura në paragrafin 1. të këtij neni. Personi i tillë konsiderohet penalisht përgjegjës, por këto rrethana merren parasysh nga gjykata kur vendos për kohëzgjatjen dhe llojin e sanksionit ose masës së trajtimit të detyrueshëm”.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 të KPRK-së.

Sa i përket rrethanave rënduese, gjykata ka gjetur si rrethanë rënduese mënyrën e kryerjes së veprës penale, rrethanat në të cilat ishte kryer vepra penale. Po ashtu gjykata pat parasysh faktin se i njëjti sipas të dhënave mbi të kaluarën kriminale i njëjti figuronte se ka kryer edhe vepra të tjera penale. Ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, faktin se i njëjti ka shprehur keqardhje dhe është penduar për ndodhjen e rastit, premtimin se nuk do ta përsëris këtë vepër penale, faktin se jeton në kushte të vështira ekonomike, personalitetin dhe gjendjen e përgjithshme, ashtu që edhe nga raporti për gjendjen mendore rezulton se i njëjti vuan nga çrregullim psikotik si pasojë e abuzimit me substanca të ndryshme psikoaktive, moshën e tij të re, si dhe faktin se kjo vepër është kryer në gjendjen të aftësisë së zvogëluar mendore, rrethanë kjo që vet ligji e parasheh si rrethanë lehtësuese.

Gjykata ndaj të akuzuarit ka shqiptuar edhe masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, duke u bazuar në nenin 87 par. 1 të KPRK-së, pasi që ekziston rreziku serioz se i akuzuari do të kryej vepër tjetër, se ky trajtim është i nevojshëm për të shmangur kryerjen e veprës tjetër penale, e po ashtu se ky trajtim është i mjaftueshëm për të shmangur rrezikun serioz. Gjykata konstaton se bazuar në ekspertizën psikiatrike, në rastin konkret kemi të bëjmë me person i cili si pasojë e abuzimit me substanca psikopative ka çrregullime mendore, andaj edhe për shkak të këtyre çrregullimeve ka rrezik që të kryej vepër tjetër penale apo edhe trajtimi është i nevojshëm për të shmangur rrezikun për vepra tjera. Prandaj, gjykata e shqiptoj këtë masë në liri si masë adekuate dhe të përshtatshme për trajtimin e të pandehurit kohë pas kohe kur ai ka nevojë për një trajtim të tillë, dhe se kjo masë do të jetë në interes të akuzuarit. Kjo masë do të zbatohet në Qendrën e Shëndetit Mental në Mitrovicë, institucion ky i propozuar nga ekspertiza psikiatrike.

Masa e trajtimit të detyruar psikiatrik në liri do të zgjasë derisa institucioni shëndetësor përgjegjës për shërimin mendor të konstatojë se më nuk është e nevojshme kjo masë. Ndërsa kufizimi që nuk mund të zgjasë më shumë se dy /2/ vjet, është bazuar në nenin 87 par. 3 të KPRK, ku parashihet se trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri nuk mund të zgjasë më shumë se dy vjet nëse i është shqiptuar kryerësit me aftësi esencialisht të zvogëluar mendore. Ndërsa në kuptim të nenit 86 par. 5 të KPRK-së, i akuzuari është paralajmëruar se në rast se nuk e zbaton vullnetarisht masën, e braktisë trajtimin apo kanoset se do kryej vepër tjetër, gjykata do të ia zëvendësoj trajtimin në liri me masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin përkatës shëndetësor.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me kusht dhe me gjobë ndaj të akuzuarit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit. Po ashtu, Gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së,

që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i pandehuri të përmbahen nga çfarëdo veprimi që janë të dëmshme për shoqërinë në përgjithësi.

Llogaritja e paraburgimit në dënimin e shqiptuar:

Gjykata duke pasur parasysh nenin 79 të KPRK-së, meqë kjo dispozitë përcakton se masat-paraburgimi dhe çdo kufizim i lirisë duhet të llogaritet në dënimin e shqiptuar. Gjykata mbi këtë bazë ka llogaritur kohën e kaluar nën masën e paraburgimit në dënimin e shqiptuar për të pandehurin.

Ndërprerja e masës së paraburgimit:

Gjykata, ka vendosur si në pikën 3 të këtij Aktgjykimi dhe ndaj të akuzuarit e ka ndërprerë masën e paraburgimit, në kuptim të nenit 367 par. 4, nën par. 4.4 të KPP-ës. Arsyet në lidhje me këtë i ka dhënë në aktvendimin për ndërprerjen e kësaj mase.

Shpenzimet e procedurës:

Vendimin për shpenzimet e procedurës, për pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.1 dhe 2.6 dhe nenit 453 par.1 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet për ekspertë dhe të paushallit gjyqësor. Në emër të ekspertizës mjeko ligjore është obliguar të paguaj shumë prej 300 euro, në emër të paushallit gjyqësor është obliguar që t'i paguajë 10 euro. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në shumën prej 30 euro, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Kërkesa pasurore juridike:

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 463 të KPP-së, duke qenë se të dëmtuarit në seancën e shqyrtimit fillestar kanë deklaruar se nuk paraqesin kërkesë pasurore juridike.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 453 e 463 të KPP-së nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si ne diapozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.04/2021, datë 19.02.2021

G j y q t a r i:

Gëzim ADEMI

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.